



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.318/2019

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Adnan Konushevci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore: Florije Krasniqi, duke vendosur lidhur me ankesën e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shpërndarjes së materialit zgjedhor në ditën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të datës 06.10.2019, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.10.2019, mori këtë:

#### V E N D I M

**Refuzohet e pabazuar** ankesa e Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, Anr.318/2019 e datës 06.10.2019, me të cilin ka kërkuar që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) t'i shqiptohet gjobë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes- shpërndarja e materialit zgjedhor në ditën e votimit.

#### A r s y e t i m

Parashtruesi i ankesës, Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), me datën 06.10.2019, ka parashtruar ankesë në PZAP, me të cilën pretendohet se në ditën e votimit më datë 6 Tetor 2019, në afërsi me pak se 100 metra afër Qendrës së Votimit, simpatizantët e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), kanë bërë shpërndarjen e materialit zgjedhor për votuesit. Më këtë rast pretendohet se një gjë e tillë bie ndesh me Rregullen Zgjedhore nr.11/2013 neni7.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore si dhe provave materiale-fotografia, e bashkangjitur që gjendet në shkresat e lëndës, në kuptim të nenin 117 par.2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

#### **Ankesa është e pabazuar**

Paneli vlerëson se në bazë të fotografisë së prezantuar si provë materiale, e cila gjendet në shkresat e lëndës, nuk mund të konstatohet qartë dhe bindshëm siç përcaktohet me nenin 117 parag.3 të LZP-së, për të provuar se shkelësi i supozuar ka shkelur Kodin e Mirësjelljes, ashtu

që në afërsi të Qendrës së Votimit në një distancë më të afërt se 100 metra është i vendosur poster i kandidatit të Partisë Demokratike Gani Halili.

Në fotografi shihet poster i vendosur dhe qendra e votimit mirëpo nuk ka mundësi nga një fotografi e tillë të identifikohet largësia në mes të vendit të vendosur poster dhe qendra e votimit, dhe si rrjedhojë në pamundësi të identifikimit të largësisë, është e pamundur të përcaktohet distanca e kërkuar me ligj.

Nuk është kontestues fakti se përmes fotografisë së dërguar si provë vërehet se disa persona janë duke qëndruar afër objekti, mirëpo nuk di.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**  
Anr.318 /2019 më datën 07.10.2019

**Kryesuese e Panelit**  
**Gyltene Sylejmani**

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.*

